



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/



REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME

ZYRA E KRYETARIT /KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr. i Protokollit: 02/ 755

Data: 19/06/2026

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 7 dhe 9 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës Shtimes, neni 54, sipas kërkesës së znj. Lindita Ymeri, Menaxhere për Zhvillimin e Kapaciteteve në Asociacionin e Komunave të Kosovës – AKK, për themelimin e Grupit të përfaqësuesve nga komuna, merr:

VENDIM

Themelohet Grupi i përfaqësuesve nga Komuna e Shtimes për zbatimin e aktiviteteve të parapara me Projektin ReLOaD3, në këtë përbërje:

-Shqiprim Hyseni, Përgjegjës për Administratë Publike, E-mail: shqiprim.hyseni@rks-gov.net; tel: +38345654902

-Fatimire Ferati zyrtare në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport E-mail: fatmire.ferati@rks-gov.net; tel: +38344228533

1. Grupi i përfaqësuesve nga Komuna do të fillojnë bashkërisht zbatimin e aktiviteteve të parapara me projektin ReLOaD3 në përputhje me nenin 7 dhe 9 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe metodologjinë LOD. Ekipi i projektit do të bashkëpunojë gjatë gjithë fazave të zbatimit të projektit; do të njoftojë rregullisht Kryetarin me ecurinë e aktiviteteve të projektit si dhe do t'i kryejë edhe punët tjera që kërkohen për projektin e cekur.

2. Grupi i përfaqësuesve për zbatimin e aktiviteteve të parapara të projektit ReLOaD3 ka për obligim që të bashkëpunojë me ekipin e projektit gjatë të gjitha fazave të zbatimit.

3. Anëtarët e grupit të përfaqësuesve do të kenë rol në Komisionin vlerësues të projekt-propozimeve, në Komisionin e ankesave dhe në Komisionin për monitorim dhe raportim të projekteve.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

znj. Lindita Ymeri – AKK

QSHO/Arkivës

